



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrašnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs

Akademia e Kosovës për Siguri Publike

Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost / Kosovo Academy for Public Safety

PLANI I INTEGRITETIT

AKSP 2024 -2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs

Akademia e Kosovës për Siguri Publike
Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost / Kosovo Academy for Public Safety

Në mbështetje të nenit 25 të Ligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (Gazeta Zyrtare nr. 19, datë 21.07.2022), udhëzimeve për përpilimin dhe zbatimin e planeve të integritetit, të përcaktuara me Metodologjinë për Planet e Integritetit, të miratuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit si dhe nenit 14 paragrafit 1, nën-paragrafi 1.2 të Ligjit Nr. 04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (Gazeta Zyrtare nr. 26, datë 25.11.2011), Drejtori i Përgjithshëm i AKSP-së me datë 22.12.2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Plani i Integritetit të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike për vitet 2024-2026 i hartuar nga grupi punues i caktuar me vendimin nr.164 datës 22/08/2023
2. z. Mentor Habibaj, Zyrtar i Lartë për Planifikim dhe Zhvillim – caktohet person përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Planit të Integritetit nga pika 1 e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Ky vendim nxirret me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore të përcaktuara me Ligjin Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (Gazeta Zyrtare nr. 19, datë 21.07.2022), në raport me detyrimet e administratës qendrore dhe agjencitë e pavarura, si dhe autoritetet komunale për miratimin e Planeve të Integritetit.

Në kuadër të kësaj, sipas udhëzimeve për përpilimin dhe zbatimin e planeve të integritetit të Metodologjisë për Planet e Integritetit, të miratuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 22/12/2023 zv.Drejtori i Përgjithshëm i AKSP-së nxjerr vendim për miratimin e Planit të Integritetit, të hartuar nga grupi punues, i caktuar me Vendim nr.164 datë 22/08/2023, të theksuar si në pikën 1 të dispozitivit të Vendimit.

z, Mentor Habibaj sipas pikës 2 të dispozitivit të këtij vendimi caktohet person përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Planit të Integritetit, i cili monitoron procesin sipas planit të integritetit, zbatimin e masave të përmirësimit nga institucioni, përgatit treguesit për vlerësimin e efikasitetit dhe vlerësimin e rezultateve të masave të propozuara për përmirësimin e integritetit.

Nga ajo çfarë u theksua në arsyetim, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Datë: 22.12.2023

Kastriot Jashari

Zëvendësues i Drejtorit të Përgjithshëm të AKSP-së

Vendimi iu dërgohet:

- Anëtarëve të grupit punues;
- Personit përgjegjës për monitorim
- Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, si dhe
- Arkivit të AKSP-së

PËRMBAJTJA

VENDIMI I MIRATIMIT	2
PËRMBAJTJA	4
LISTA SHKURTESAVE	5
DEKLARATA E INTEGRITETIT.....	6
HYRJE.....	8
PLANI I INTEGRITETIT	9
PARIMET E MENAXHIMIT TË INTEGRITETIT.....	11
OBJEKTIVAT E PLANIT TË INTEGRITETIT	12
PROCESI I ZHVILLIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT.....	12
Fazat e zhvillimit të Planit të Integritetit	13
METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TË RREZIKUT.....	14
Matrica vlerësimit të rrezikut	14
Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut.....	15
Prioriteti i rreziqeve	16
MONITORIMI I ZBATIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT DHE RAPORTIMI	17
FUSHAT E RREZIKUT	18
Fushat e përgjithshme të Rrezikut.....	18
Fushat specifike të rrezikut.....	18
PYETËSORI.....	18
PLANI I VEPRIMIT	18

LISTA SHKURTESAVE

AKSP	Akademia e Kosovës për Siguri Publike
APK	Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit
FSP	Fakulteti i Sigurisë Publike
FSP	Fakulteti i Sigurisë Publike
IHZH	Instituti për Hulumtim dhe Zhvillim
ISP	Institucionet e Sigurisë Publike që veprojnë në AKSP
PK	Policia e Kosovës
IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
AME	Agjencioni i Menaxhimit Emergjentë
SHKK	Shërbimi Korrektues i Kosovës
SHSK	Shërbimi Sprovues i Kosovës
DK	Dogana e Kosovës
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
D.P	Drejtori i Përgjithshëm i AKSP-së
DTPA	Departamenti i Trajnimeve dhe Përkrahjes Arsimore
DPSÇL	Departamenti për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore
DAB	Divizioni i Auditimit të Brendshëm
DMJ	Divizioni për Mardhënie me Jashtë
DBNJ	Divizioni i Burimeve Njerëzore
DBF	Divizioni për Buxhet dhe Financa
MEDIA	Zyrtari për informim pranë AKSP
Palët e interesit	Institucionet e Sigurisë Publike, duke mos u kufizuar vetëm në: Policia e Kosovës (PK), Dogana e Kosovës (DK), Shërbimi Korrektues i Kosovës (SHKK), Shërbimi Sprovues i Kosovës (SHSK), Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) dhe Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (AME)
Vijues	Personat të cilët vijojnë trajnime dhe arsim të lartë në Akademi
Partnerët Ndërkombëtar	Partnerët e përhershëm që veprojnë dhe bashkëpunojnë me AKSP-në si ICITAP, OSBE,

DEKLARATA E INTEGRITETIT

Akademia e Kosovës për Siguri Publike - AKSP si institucion përgjegjës për ngritjen e kapaciteteve të Institucioneve të Sigurisë Publike, si një nga vlerat më të larta njerëzore dhe profesionale konsideron Integritetin. Integriteti kuptohet si promotor i jetës i cili na përcjellë në çdo sferë, andaj edhe ushtrimi i funksioneve dhe detyrave me integritet nga zyrtarët e AKSP-së krijon besueshmëri tek qytetarët, palët e interesit dhe partnerët tanë ndërkombëtar.

Kjo deklaratë ka për qëllim ofrimin e një deklaratë gjithëpërfshirëse që pasqyron qartazi politikat, procedurat dhe masat tona operative përkitazi me integritetin, etikën, kulturën organizative, transparencën dhe llogaridhënien.

Andaj bazuar në të lartcekurat punën dhe proceset e Institucionit tonë jemi munduar ti harmonizojmë aktivitetet me parimet dhe vlerat e proklamuar në dokumentet tona më të rëndësishme duke siguruar respektimin dhe bërjen e dukshme të tyre.

AKSP-ja këtë plan e sheh si bazë për përmirësimin e vazhdueshëm në sistemin e menaxhimit dhe fuqizimit të rezistencës së organizatës ndaj korrupsionit dhe rrjedhimisht të zvogëlojnë nivelet e korrupsionit. Kjo mund të arrihet përmes krijimit të mekanizmave duke përfshirë parandalimin, kontrollin, llogaridhënien dhe transparencën.

Zotohemi që AKSP, me gjithë sinqeritetin dhe përkushtimin duhet të zhvillojmë më tej kapacitetet e personelit tonë, për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive të gjitha sfidave që kanë të bëjnë me integritetin, si dhe për të menaxhuar në mënyrë adekuate rreziqet e shumta e të ndryshme të integritetit me të cilat ne ballafaqohemi.

Prandaj ne si AKSP , jemi të përkushtuar që jo vetëm të implementojmë masat e planifikuara, por edhe të bëjmë përpjekje të suksesshme për të integruar menaxhimin e riskut ndaj integritetit në kulturën e institucionit në një mënyrë të qëndrueshme. Qasja ndaj fenomeneve negative do të jetë zero tolerancë.

Të gjithë ne jemi përgjegjës për parandalimin efikas, zbulimin me kohë dhe hetimin e korrupsionit, mashtrimit apo çdo shkeljeje tjetër të integritetit. Ne i mbajmë zotimet tona

karshi palëve tanë të interesit, pa përjashtuar përgjegjësit tanë që veprojnë tek ne ,ne arrijmë te fitojmë besimin duke vepruar me integritet dhe sjellje në mënyrë modeste duke jetësuar etiken.

Në fund, falënderojmë të gjithë anëtarët dhe ekspertët e Grupit Punues, përkushtimi dhe puna shumë e madhe e të cilëve ka bërë të mundur ta kemi në duart tona këtë Plan të Integritetit për tri vitet e ardhshme 2024-2026.

Mbetet që në të ardhmen, të gjithë zyrtarët, palët e interesit të AKSP-së të japin kontributin e tyre maksimal për ta implementuar këtë dokument, gjë që mund të arrihet vetëm duke forcuar dhe avancuar bashkëpunimin që tashmë e kemi.

Me respekt

Kastriot Jashari

Zëvendësues i Drejtor i Përgjithshëm i AKSP

HYRJE

Në bazë të Nenit 25 të Ligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit/APK, udhëzimeve për përpilimin dhe zbatimin e planeve të integritetit të përcaktuara me Metodologjinë për Planet e Integritetit të miratuar nga APK obligojnë të gjitha institucionet të zhvillojnë dhe miratojnë planet e integritetit.

Andaj bazuar në obligimet ligjore dhe dokumentet e lartcekura edhe AKSP ka hartuar Planin e Integritetit Institucional për vitet 2024-2026. AKSP është institucion përgjegjës për ofrimin e trajnimeve dhe arsimit të lartë, zbatimin e politikave dhe strategjive të trajnimit, arsimit të lartë si dhe zhvillimin e kapaciteteve në fushën e sigurisë publike për të gjitha Institucionet e Sigurisë Publike duke mos u kufizuar vetëm në: PK, SHKK, SHSK, DK, AME dhe IPK-në.

Plani i integritetit është dokument strategjik dhe operativ që mbështetet mbi gjetjen e provave, rezultateve të procesit sistematik të vlerësimit të rrezikut të integritetit të ndërmarre brenda organizatës. Ai bazohet në identifikimin konkret të rreziqeve ,analizën dhe vlerësimin e nivelit të rrezikut, prioritet për ndërhyrje, dhe specifikon masat sipas rreziqeve për arritjen e objektivave të saj.

Qëllimi kryesor i Planit të Integritetit është ngritja e vetëdijes individuale dhe institucionale si mënyra për parandalimin e fenomeneve që mund të jen të pranishme. Andaj synimi ynë do të jetë ndërtimi i mureve të sigurisë për të penguar keq edukuarit dhe individ te pa ndërgjegjshëm, krijimine e politikave për ngritje profesionale, intelektuale dhe edukative. Plani i Integritetit shërben edhe si mjet preventiv strategjik për të fuqizuar integritetin e institucionit, ku përfshihet integriteti individual, profesionalizmi, etika, integriteti institucional si dhe zbatimi i vlerave morale dhe standardeve profesionale. Duke marre parasysh qëndrueshmërinë dhe pasojat afatgjate të veprimeve ne e lidhim integritetin me shqetësime tjera ,mendojmë gjerësisht për të gjitha çështjet dhe veprimë në përputhje me rrethanat, konformë parimeve të funksionit dhe mandatit tonë. Ne përpiqemi te ofrojmë shërbimet cilësore me kohë të duhur ,në mënyre efektive dhe efikase duke respektuar standardet më të larta të integritetit profesional. Ne jemi të përgjegjshëm individualisht dhe kolektivisht për sjelljen tone etike.

PLANII INTEGRITETIT

Si dokument plani i integritetit përcakton strategjitë dhe hapat që institucioni duhet ndjekë për të siguruar integritetin në veprimtarinë e vet. Ky plan përfshinë masat dhe politikat për të parandaluar korrupsionin, mashtrimin dhe veprimet e tjera që mund të dëmtojnë integritetin e institucionit.

Plani për Integritet si dokument strategjik dhe operativ do shërben si një mjet i rëndësishëm për fuqizimin e integritetit institucional. Ky plan kuptohet si një respektim i drejtpërdrejtë i vlerave morale, standardeve profesionale dhe i rregullave të zbatueshme normative. Në përgjithësi plani i integritetit është një instrument i rëndësishëm për të siguruar që institucioni të mbajë nivelin e lartë të integritetit në të gjithë veprimtarinë e tij.

Plani i integritetit mundëson:

- Identifikimin e rreziqeve përkatëse të korrupsionit në fusha të ndryshme të punës
- Vlerësimin e çfarëdo lloj rreziku që mund të paraqes rrezik për shfaqjen e korrupsionit për një organizatë ;
- Përcaktimin e masave për të parandaluar ose eliminuar rreziqet e korrupsionit dhe sjelljeve tjera jo profesionale;
- Forcimi i imazhit dhe besueshmërisë së Institucionit - respektimi i dhe ndjekja e planit të integritetit mund të përmirësoj imazhin dhe besueshmërinë e saj në raport me të tjerët;
- Ndërgjegjësimi i personelit - trajnimi dhe ndërgjegjësimi rreth rreziqeve të integritetit ndihmojnë personelin të kuptoj rëndësinë e sjelljes në përputhje me rregulloret e përcaktuara;
- Përmirësimi i produktivitetit dhe performancës - mjedisi i cili promovon integritetin mund të ndikojë pozitivisht në klimën e institucionit duke sjellë produktivitetin dhe performancën;
- Përputhshmëria me ligjin - Hartimi i planit të Integritetit siguron që aktet e institucionit të kenë përputhshmëri me aktet relevante për parandalimin e pasojave ligjore;

Plani i Integritetit do të kontribuojë në mënyrë domethënëse në:

- Rritjen e mundësive që AKSP të arrijë objektivat e saja organizative duke vënë përpara një menaxhim proaktiv të rrezikut të integritetit. Kjo do të përmirësojë rezistencën organizative ndaj korrupsionit dhe do të zvogëlojë mundësitë për korrupsion;
- Përqendrimin tek prioritetet, në bazë të identifikimit dhe vlerësimit të rrezikut që do ta ndihmojnë institucionin të shpërndajë në mënyrë efektive burimet në dispozicion kundër korrupsionit, që të shfrytëzohen në mënyrën më mirë të mundshme;
- Përmirësimin e kontrolleve operacionale ndaj shkeljeve të integritetit që do të rrisin efektivitetin, efikasitetin dhe transparencën e të gjitha proceseve
- Mbajtjen e një sistemi për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat dhe standardet ligjore dhe procedurale;
- Krijimin e një mjedisi të brendshëm të favorshëm kundër korrupsion përmes trajnimit të synuar dhe ndërgjegjësimit, si dhe duke inkurajuar një bashkëpërgjegjësi të gjithë stafit në procesin e zhvillimit, zbatimit dhe monitorimit të planeve të integritetit;
- Rritjen e besimit të punonjësve tonë dhe palëve të jashtme të interesit në përkushtimin për integritet që demonstrohet nga AKSP.

Me zbatimin e këtij Plani, AKSP do të vendoset më mirë për të siguruar një shpërndarje efektive, efikase, transparente dhe etike të rezultateve të synuara. Plani mbështetet në rezultatet e një planifikimi gjithëpërfshirës për integritetin dhe të një procesi vlerësimi të riskut që AKSP e ka bërë në periudhën 2024 - 2026. Prosesi ka përfshirë identifikimin e pikave të dobëta të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike në rastet e shkeljeve të integritetit dhe vlerësimine tyre duke marrë parasysh: (1) dëmet materiale dhe jo materiale që shkaktojnë shkeljet përkatëse potenciale dhe (2) gjasat që këto ngjarje të ndodhin parë nga rezistenca aktuale organizative e vërtetuar nga rregulloret, procedurat, kodet, praktikrat relevante dhe nga përfshirja e stafit.

PARIMET E MENAXHIMIT TË INTEGRITETIT

Lidershipi

Menaxhmenti i lartë duhet në mënyrë të dukshëm të demonstrojë një përkushtim aktiv të bazuar në fakte për integritetin. Kjo do të kërkonte nga ata që të udhëheqin procesin qysh nga fillimi, përmes zhvillimit të politikave të integritetit dhe Kodit të Etikës. Shumë e rëndësishme është që ky përkushtim të jetë i vazhdueshëm dhe që të kuptohet dhe të shihet mirë nga të gjithë stafi dhe palët interesit.

Përfshirja e personelit

Pjesëmarrja e gjithë stafit është shumë e rëndësishme në zbatimin e suksesshëm të sistemit për menaxhimin e integritetit. Megjithatë, përfshirja kuptimplote kërkon edukimin e përshtatshëm dhe trajnimin lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me integritetin, ngritjen e vetëdijes duke krijuar kështu besim dhe mjedis pozitiv për punë. Komunikimi efektiv i brendshëm dhe i jashtëm dhe koordinimi janë të rëndësishme për punë të suksesshme ekipore në mënyrë që të gjitha palët e përfshira të marrin dhe të mbajnë të njëjtin kuptim për projektin derisa është duke u zbatuar.

Qasja sistemore

Identifikimi i fushave potenciale të korrupsionit dhe menaxhimi i proceseve të ndërlidhura për të siguruar integritet kërkon qasje sistemore. Kjo kërkon nga AKSP ti kushtojë vëmendje të gjitha njësive dhe të analizojnë marrëdhënien dhe ndërvarësinë ndërmjet tyre. Një gjë e tillë arrihet brenda për brenda grupit punues në AKSP.

Transparenca dhe hapësira për raportim

Sigurimi i një mjedisi të hapur dhe transparent ku personeli ka liri për të raportuar për shkeljet eventuale dhe këto bëhen duke u ngrit vetëdijesimin përmes trajnimeve të personelit.

OBJEKTIVAT E PLANIT TË INTEGRITETIT

Objektivi kryesor i Planit të Integritetit është të rrisë dhe rendit përpjekjet dhe burimet për të parandaluar/eliminuar në mënyrë progresive dhe sistematike shkaqet dhe efektet shkatërruese të korrupsionit dhe të sjelljeve jo etike në AKSP.

Objektivat specifike janë:

- Sigurimi i një mekanizmi gjithëpërfshirës, ku të gjithë zyrtarët, vijuesit dhe ofruesit e shërbimeve mund të përfshihen në luftën kundër korrupsionit dhe sjelljeve jo etike në punën e Institucionit.
- Rritja e vetëdijesimit të personelit dhe vijuesve mbi rreziqet e korrupsionit dhe të sensibilizojë ata për rolin e tyre në parandalimin/eliminimin e korrupsionit dhe sjelljeve jo etike.
- Përmirësimi dhe forcimi i mekanizmave të raportimit të rasteve të korrupsionit dhe sjelljeve jo etike në AKSP.
- Rritja e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve në Institucion.
- Krijimin dhe mirëmbajtjen e partneriteteve në luftën kundër korrupsionit dhe sjelljeve jo etike.

PROCESI I ZHVILLIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT

Plani i Integritetit është një dokument që vlerëson integritetin e punës, integritetin institucional, pajtueshmërinë dhe mënyrën se si institucioni dhe punonjësit e tij veprojnë përmes vetëvlerësimit të ekspozimit ndaj rreziqeve ndaj ndodhjes dhe zhvillimit të korrupsionit dhe / ose sjelljeve tjera të papranueshme etike dhe profesionale.

Plani i Integritetit kryesisht përbëhet nga:

- ❖ Regjistrimi i rreziqeve të identifikuara dhe të vlerësuara për të gjitha fushat e funksionimit të AKSP-së.

- ❖ Përcaktimi i masave për përmirësimin e integritetit që përshkruan në detaje të gjitha masat që duhet të zbatohen për të zvogëluar rreziqet e integritetit, si dhe afatin kohor përkatës dhe përgjegjësitë organizative për zbatimin e masave.

Me rastin e zhvillimit të Planit të Integritetit bëhet vlerësimi i rreziqeve të integritetit për të gjitha fushat e funksionimit të AKSP-së. Të gjithë zyrtarët kanë patur mundësi të marrin pjesë në vlerësimin e rrezikut të fushave të funksionimit të njërive dhe Institucionit dhe të propozojnë masa për të përmirësuar integritetin dhe cilësinë e përgjithshme të menaxhimit si dhe ofrimin e shërbimeve.

Fazat e zhvillimit të Planit të Integritetit

Zhvillimi i Planit të Integritetit për AKSP përbëhet prej disa faza si në vijim:

- **Faza përgatitore** - Drejtori i Përgjithshëm ka themeluar grupin e punues me vendim ku në grup punues janë përfshirë niveli menaxherial dhe profesional. Po ashtu, Drejtori me vendim ka emëruar edhe koordinatorin për zhvillimin e planit të integritetit. Ky grup punues ka bërë mbledhjen e informacionit të nevojshme për zhvillimin e planit të integritetit si dhe njoftimin e të gjithë stafit për rëndësinë e Planit të Integritetit.
- **Faza e vlerësimit të rrezikut të integritetit** - gjatë kësaj faze koordinatori së bashku me grupin punues kanë analizuar dokumentacionin e mbledhur (legjislacionin dhe aktet nënligjore të zbatueshme në punën e administratës; përshkrimet e vendit punës dhe fushëveprimin e çdo njësie organizative si dhe si dhe çdo proces për vendimmarrje dhe ofrimin e shërbimeve . Mbi bazën e analizës së gjendjes aktuale ka përcaktuar fushat e rrezikut dhe ka identifikuar dhe vlerësuar rreziqet. Po ashtu përfshirja e pjesëmarrësve në procesin e hartimit të planit (është zhvilluar edhe pyetësorin anonim me stafin), konsultimi me akterët për mbledhjen e opinioneve të tyre për identifikimin e pikave potenciale të cenueshme në Institucion.
- **Faza e përcaktimit të prioriteteve, dhe propozimit të masave për përmirësimin e integritetit** - kjo fazë ka përfshirë përcaktimin e fushave dhe prioriteteve për

intervenimin , përcaktimi i masave për parandalimin/eliminimin e rreziqeve dhe përgjegjësit për zbatim.

- **Faza e monitorimit dhe raportimit të planit të integritetit** - përfshin monitorimin, vëzhgimin dhe regjistrimin e rregullt të aktiviteteve që ndodhin në një Plan të Integritetit dhe procesin e mbledhjes së informacionit për të gjitha aspektet e zbatimit të Planit të Integritetit. Ndërsa raportimi mundëson që informacionet e mbledhura të përdoren në marrjen e vendimeve që përmirësojnë e zbatimin e objektivave të Planit të Integritetit.

METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TË RREZIKUT

Metodologjia e vlerësimit të rrezikut është një proces i strukturuar që ka për qëllim të identifikoj, vlerësoj dhe menaxhojë rreziqet potenciale në një institucion.

Vlerësimi i rrezikut do të thotë renditja e rreziqeve më të mëdha në krye të listës, që paraqesin efekte thelbësore në integritetin institucional dhe mund të rrezikojnë efikasitetin, besueshmërinë dhe imazhin e jashtëm të Institucionit. Kjo duhet të jetë baza për përcaktimin e masave për trajtimin e rrezikut. Prandaj, prioritetet përcaktohen ashtu që resurset e kufizuara në dispozicion për trajtim, mund të vendosen aty ku ndihet se janë më të nevojshme. Në përgjithësi, rreziqet e kategorizuara si të vogla, përputhen me standardet për marrje të rrezikut dhe nuk imponojnë nevojën për masa shtesë të trajtimit, por kërkojnë monitorim të efikasitetit të masave ekzistuese të trajtimit/kontrollit. Në anën tjetër, rreziqet madhore kërkojnë trajtim të menjëhershëm me masat adekuate.

Pas përcaktimit të dy parametrave, gjasave të ndodhjes së rrezikut dhe pasojave (ndikimit) të rrezikut të ndodhur, grupi punues ka përcaktuar nivelin e rrezikut për të gjitha rreziqet e identifikuar dhe të vlerësuara, duke përdorur Matricën e Rrezikut. Niveli përfundimtar i rrezikut përcaktohet bazuar në Matricën e Rrezikut si kombinim i gjasave dhe pasojave.

Matrica vlerësimit të rrezikut

Matrica e vlerësimit të rrezikut mundëson të llogaritet rreziku në një fushë, aktivitetet institucionale për një kohë shumë të shpejtë, duke identifikuar të gjitha gjërat që mund të shkojnë keq dhe duke peshkuar dëmin e mundshëm. Kjo e bën më të lehtë prioritizimin e

çështjeve dhe ndërmarrjen e veprimeve dhe masave aty ku është më e nevojshme për të mbajtur fushën dhe aktivitetet në rrugë të mbarë.

Figura 1. Matrica e vlerësimit të rrezikut

Pasoja/Ndikimi	Madhor	10																			
		9																			
		8																			
	Mesatar	7																			
		6																			
		5																			
		4																			
	Vogël	3																			
		2																			
		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10										
Intensiteti rrezikut i (gjasat X ndikimi)		Ulët			Mesatar							Lartë									
		Probabiliteti/Gjasat																			


Intensiteti i rrezikut fitohet duke shumëzuar probabilitetin/ gjasën me pasojën/ ndikimin, duke përdorur matricën e rrezikut, "ndikimi (1-10) x pasoja (1-10)", treguar në figurën si më lartë.


Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut

Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut të cenimit të integritetit vlerësohet nga 1 në 100, si në tabelën e më poshtme:

Ulët	Mesatar	Lartë
1 – 15 pikë	16 - 48	49 - 100

■ Rreziku me intensitet të ulët - mundësia e ndodhjes së cenimit të integritetit ose formave tjera të dëmtimit të integritetit është shumë e vogël për shkak të masave ekzistuese të kontrollit, (rreziku nuk u shfaq në të kaluarën ose shfaqet shumë rrallë, kështu që nuk ka gjasa që kjo të ndodhë në të njëjtën periudhë kohore në të ardhmen). Vlerësimi i ndikimit të shfaqjes së rrezikut - Ndikimi për integritetin e institucionit është i parëndësishëm.

 Rreziku me intensitet të mesëm – ndodhja e cenimit të integritetit ose formave tjera të dëmtimit të integritetit është e mundur, por masat e kontrollit menaxhojnë këtë rrezik, (rreziku është shfaqur në një numër rastesh në të kaluarën, kështu që probabiliteti i ndodhjes në të njëjtën periudhë kohore në të ardhmen është i moderuar). Vlerësimi i ndikimit të shfaqjes së rrezikut - Ndikimi i është i rëndësishëm për integritetin e institucionit.

 Rreziku me intensitet të lartë – cenimi i integritetit ose format e tjera të dëmtimit të integritetit janë tashmë të pranishëm në këtë proces ose ka të ngjarë të ndodhin, (rreziku është shfaqur shpesh në të kaluarën dhe ekziston një gjasë e madhe që kjo të ndodhë në të njëjtën periudhë kohore në të ardhmen). Vlerësimi i ndikimit të shfaqjes së rrezikut – Ndikimi është shumë i rëndësishëm për integritetin e institucionit.

Prioriteti i rreziqeve

Prioriteti i rrezikut nënkupton renditjen e rreziqeve të integritetit, duke filluar nga rreziqe më parësore që paraqesin ndikim thelbësor në integritetin e institucionit dhe që mund të rrezikojnë efektshmërinë dhe reputacionin e tij, deri te rreziqet e ulëta të cilat nuk mund të kenë nevojë për masa, por mjafton të monitorohen në mënyrë të vazhdueshme.

Pas përcaktimit të mundësisë së ndodhjes së rreziqeve dhe pasojave të rreziqeve të ndodhura, vijohet me përcaktimin e nivelit të rrezikut për të gjitha rreziqet e identifikuara dhe të vlerësuara, sipas matricës së rrezikut (në figurën nr.1).

Renditja e rreziqeve bëhet sipas rëndësisë, dhe përfshin vlerësimin midis mundësisë së ndodhjes apo shfaqjes së një rreziku dhe ndikimit të tij në integritetin e institucionit.

MONITORIMI I ZBATIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT DHE RAPORTIMI

Zbatimi i Planit të Integritetit do të monitorohet në vazhdimësi me mekanizma përkatës, do të rishikohet periodikisht dhe do të azhurnohet në përputhje me zhvillimet relevante normative, institucionale, procedurale dhe të personelit brenda mjedisit të Institucionit. Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit është i rëndësishëm për t'u siguruar se kontrolli i rrezikut të integritetit dhe masat për trajtim janë efektive, si në projektim ashtu edhe në funksionim, dhe se procedurat janë kuptuar si dhe plani integriteti është ndjekur.

Gjithashtu monitorimi duhet të përcaktojë nëse masat e përdorura për trajtimin e riskut kanë prodhuar efektet e planifikuara, kanë zbuluar ndryshimet në kontekstin e jashtëm dhe të brendshëm përfshirë ndryshimet e vetë rrezikut, ndryshime që kërkojnë rishikimin e trajtimit dhe prioriteteve të rrezikut si dhe kanë identifikuar cilat mësimë duhen nxjerrë për planifikim në të ardhmen. Raportimi i rregullt siguron se zbatimi i Planit bëhet në përputhje me orarin dhe rezultatet e planifikuara për arritje.

Me qëllimi të sigurimit të zbatimit të planit të integritetit krijohen mekanizmat për monitorimin dhe raportimin për zbatimin e Planit të Integritetit.

Fillimisht *Caktohet Personi përgjegjës për raportimin e zbatimit të Planit të Integritetit* me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm të AKSP-së.

Personi përgjegjës për raportimin e zbatimit të Planit të Integritetit është përgjegjës për:

- Përgatitë metodologjinë për monitorimin e Planit të Integritetit konformë metodologjisë për planet e Integritetit nga APK;
- Të mbledhë dhe analizon dokumentacionin e nevojshëm në lidhje me zbatimin e masave
- Harton raporte periodike dhe vjetore (çdo 6 muaj) për monitorimin e zbatimit të planit të integritetit dhe i raporton Drejtorit të Përgjithshëm të AKSP-së si dhe APK-së

Të gjithë punonjësit janë të detyruar të informojnë personin përgjegjës për situatën, veprimet, masat për të cilat ata janë të angazhuar për veprim. Të paktën një herë në vit, me kërkesë të Drejtorit të Përgjithshëm, personi përgjegjës duhet të paraqesë një raport për zbatimin e planit të integritetit.

FUSHAT E RREZIKUT

Fushat e përgjithshme të Rrezikut

- Drejtimi dhe menaxhimi;
- Politika e burimeve njerëzore dhe sjellja etike e të punësuarve;
- Planifikimi dhe menaxhimi financiar;
- Ruajtja dhe siguria e të dhënave dhe dokumenteve.
- Komunikimi dhe informimi;

Fushat specifike të rrezikut

- Auditimi i Brendshëm;
- Prokurimi publik;
- Arsimi i lartë;
- Trajnimet

PYETËSORI

Ne kuadër të zhvillimit të Planit të Integritetit, AKSP ka krijuar pyetësorin Online ku i njëjti i është dërguar tek 50 pjesëmarrës / punonjës të Institucionit nga nivele të ndryshme organizative. Po ashtu janë përfshirë anëtarët e Grupit Punues, niveli menaxherial, profesional dhe mbështetës. Nga të dhënat që kanë dal nga ky pyetësor, del që AKSP qëndron mirë në aspektin organizativ dhe përgjegjësive të ndara në njësi organizative. Rezultatet e marra nga pyetësori i zhvilluar janë pasqyruar kryesisht edhe në Fushat e Përgjithshme të Rrezikut dhe Fushat e Veçanta të rrezikut.

PLANII VEPRIMIT

Plani i veprimit është hartuar brenda kornizës së përgjithshme të përcaktuar në Planin e Integritetit konformë udhëzuesit të miratuar nga ana e APK-së. Plani i veprimit për zbatimin e kësaj strategjie përmban:

Fusha e rrezikut, përshkrimi i rrezikut, masat ekzistuese të kontrollit dhe efikasiteti i tyre në tejkalimin e rreziqeve, rezultatet e vlerësimit të pasojës dhe probabiliteti i shfaqjes së rrezikut, masat e parashikuara për eliminimin / zvogëlimin e rrezikut, personi përgjegjës për zbatimin e masave dhe afatin për zbatimin e masave.

PLANI I VEPRIMIT PËR INTEGRITET AKSP 2024-2026

Planit i Integritetit Fushat e përgjithshme të rrezikut								
Regjistrimi i rrezikut			Vlerësimi dhe matja e rrezikut			Veprimi ndaj rrezikut		
Fusha e rrezikut	Përshkrimi i Rrezikut	Masat ekzistuese të kontrollit	Gjasat	Ndikimi	Vlerësimi i rrezikut	Masat e propozuara për zvogëlimin / eliminimin e rreziqeve	Njësia /zyrtari përgjegjës	Afati i realizimit
1.	Drejtimi dhe menaxhimi	Mbikëqyrja jo efikase mbi zbatimin e aktiviteteve të planifikuara	3	8	24	Vlerësimi periodik i zbatimit të aktiviteteve - planitvjetor	DPSÇL / të gjitha njësit	Cdo tre (3) muaj raport
		Mos monitorimi dhe raportimi mbi zbatimin e Planit të Integritetit të AKSP-së	2	3	6	Monitorimi dhe hartimi i raporteve monitoruese	DPSÇL / të gjitha njësit	Çdo 6 muaj raportim
		Mungesa e procedurave të brendshme për shmangie nga konflikti interesit	3	10	30	Hartimi i aktit / politikave të brendshme	DPSÇL	2024
		Informimi i vazhdueshëm me punonjësit lidhur me proceset e institucionit dhe ofrimi këshillave nga menaxhmenti	3	5	15	Organizimi i takimeve dhe vizitave nga menaxhmenti tek punonjësit	DP - menaxhmenti	Së paku 4 takime në vit
		Mungesa e një Rexhistri të dhuratave	2	10	20	Krijimi i rexhistrit të dhuratave	Zyrtari për deklarim të pasurisë në AKSP	2024 Muajin Mars çdo viti
		Mungesa e procedurave kunder mashtrimit	5	8	40	Krijimi i procedurave/politikave kunder mashtrimit dhe senzibilizimi i stafit me politikat e reja	DPSCSL	2024
		2.	Politika burimeve njerëzore dhe etika	Mungesa e Trajnimeve rreth kodit të etikës.	3	4	12	Trajnimi i stafit rreth etikës
Mungesa e Informimit dhe sensibilizimit për ekzistencën e kodit të etikës për zyrtarët e AKSP-së dhe vijuesit në AKSP.	3			4	12	Shpërndarja e kodit të etikës dhe publikimi në web faqe.	DBNJ	Cdo fillim vit
Ngritja profesionale e kompetencës së të punësuarve në lidhje me konfliktin e interesit	3			4	12	Trajnim i stafit për fudhën e konfliktit të interesit	DBNJ / gjitha njësit	20 zyrtar të trajnuar cdo vitë
Mos Senzibilizimi dhe informimi i stafit në lidhje me konfliktin e interesit dhe korrupsionit	3			4	12	Senzibilizimi i stafit përmes njoftimeve vazhdueshme	DBNJ / gjitha njësit	Politikat dhe rregullat e dërguara cdo fillim vit

3. Planifikimi dhe menaxhimi	Mos Planifikimi i buxhetit në bazë të dokumenteve të planifikimit, (strategjive, plani performancës plani vjetor etj) dhe obligimeve tjera	Ligjet dhe aktet nënligjore	3	5	15	Te sigurohet pjesmarrja e te gjitha paleve ne planifikimet buxhetore dhe kordinimi me dokumente planifikuese	DBF	Planifikimi vjetor dhe rishikimi buxhetit cdo vit
	Inventarizimi dhe regjistrimi joefikas i asetëve		5	5	25	Perditesimi i regjistrimit te brendshem i asetëve	DBF	Çdo vit
4. Ruajtja dhe siguria e të dhënave dhe dokumenteve	Mungesa e një hapësire adekuate për arkiv	Ligjet dhe aktet nënligjore nga fusha arkives	8	8	64	Pasurimi me raftë dhe krijimi i kushteve per arkiv	DFSHP	2025
	Grumbullimi dhe jo klasifikimi i duhur nga njësit i dokumenteve që dërgohen në arkiv		5	5	25	Trajnimi i stafit dhe klasifikimi i dokumenteve per arkivim	DFSHP/ Të gjitha njësitë	2024
	Dërgimi i materialeve arkivore në arkivin shtetërorë pas afatit të ruajtjes		3	3	9	Krijimi i komisionit për vlerësim dhe klasifikim dokumenteve	D.P	2024
						Dërgimi i materialeve në arkiv shtetërorë	DFSHP	2025
	Mungesa e trajnimeve të veçanta se si të punohet me të dhënat personale dhe të mbrohen të dhënat personale.		5	5	25	Trajnimi i 20 zyrtareve per mbrojtjen e te dhenave personale	DBNJ/ të gjitha njësitë	2024-2025
5. Komunikimi dhe informimi	Vonesa në përditësimin e të dhënave dhe informacioneve në web faqe	- Ligjet dhe aktet nënligjore	3	7	21	Perditesimi i të dhënave sipas ndrushimeve të ndodhura	Media/te gjitha njesit	Vazhdimësi
	Mos prezantimi i aktiviteteve të zhvilluara në AKSP	- Rregullorja organizimit të AKSP-së	3	7	21	Ngjarjet dhe aktivitetet e publikuara në web dhe rrjetet sociale	Media / te gjitha njesit	Vazhdimësi
	Ndryshimi i web faqes dhe pasurimi me dokumente relevante		3	5	15	Web faqja e ridizajnuar dhe publikimi dokumenteve	Media / të gjitha njësit	2024 / Vazhdimësi

Fushat e veçanta të rrezikut

Regjistrimi i rrezikut			Vlerësimi dhe matja e rrezikut			Veprimi ndaj rrezikut		
Fusha e rrezikut	Përshkrimi i Rrezikut	Masat ekzistuese të kontrollit	Gjasat	Ndikimi rrezikut	Vlerësimi i rrezikut	Masat e propozuara për zvogëlimin / eliminimin e rreziqeve	Njësia/ Zyrtari përgjegjës	Afati i realizimit
1. Auditimi i brendshëm	Niveli i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga raportet Njësia e Auditorit të Brendshëm (NJAB).	Ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi	3	10	30	Rritja e zbatimit të rekomandimeve të pranuar nga DAB	D.P	Në vazhdimësi
	Mos koordinimi për përgatitjen e planeve të veprimit për implementimin e rekomandimeve nga njësiti e audituara nga DAB.		3	6	18	Organizimi i takimeve me njësiti e përfshira në diskutimin e draft raportit dhe hartimin e planit të veprimit	D.P	Pas çdo auditimi
	Mungesa e planifikimit të auditimit të bazuar në rrezik dhe auditimeve rast pas rasti		3	8	24	Hartimi i planit të auditimit të brendshëm bazuar në rezultatin e vlerësimit të rrezikut	DAB	Në vazhdimësi

2.	Prokurimi Publik	Të rritet transparenca në procesin e prokurimit, posaçërisht gjatë formulimit të kriterëve të përzgjedhjes dhe përgatitjes së publikimit të planeve /ofertave të prokurimit	Ligji për prokurimin publik	3	10	30	Trajnimi i vazhdueshëm për personelin përgjegjës të cilët përgatisin specifikacione teknike	Prokurim/DBNJ	Në vazhdimësi
		Rritja e profesionalizmit në pranimin e mallrave dhe menaxhimin e kontratave	Rregullat e KRPP	3	10	30	Trajnimi i vazhdueshëm për personelin përgjegjës në fushën e menaxhimit të kontratave dhe komisioneve të pranimit	Prokurim DBNJ	Në vazhdimësi
		Rritja e pjesëmarrësve në planifikim prokurimit		3	6	18	Organizimi i takimeve planifikuese	D.Prok	Çdo fund vit
3.	Arsimi lartë	Mos efikasiteti i shërbimeve arsimore dhe studentore	Ligjet dhe aktet nënligjore	3	9	27	Identifikimi dhe rritja e efikasitetit shërbimeve arsimore bazuar në nevoja	FSP/ DTPA	Shtator 2024
		Inspektimet e pa mjaftueshme të procesit mësimor		3	8	24	Të hartohet plani i inspektimeve dhe mbikëqyrja e zbatimit të tij	FSP	Cdo vit
		Mos respektimi i procedurave për përzgjedhjen e stafit dhe studentëve për përfaqësim të AKSP-së në ngjarje të ndryshme me karakter ndërkombëtar si: Programi i shkëmbimit (Mobiliteti), vizita, konferenca, seminare, trajnime, etj.	Udhëzimi për mobiliteti AKSP	5	10	50	Respektimi i procedurave për përzgjedhjen e stafit dhe studentëve për ngjarje të ndryshme me karakter ndërkombëtar si: Programi i shkëmbimit (Mobiliteti), vizita, konferenca, seminare, trajnime, etj	FSP/DMJ	Vazhdimësi
4.	Trajnimi	Parandalimi i ndërhyrjes në procesin e testimeve	Udhëzuesi (AKSP) nr.02/2018 për protokolle dhe procedura	1	5	5	Inspektimi dhe krahasimi i numrit të testeve (shabllonave me uniref) dhe numrit të vijuesve në trajnime. Monitorimi i qasjes në zyren e testimeve sipas librit të protokollit.	DTPA	Çdo 6 muaj hartohet raport
		Rritja e kontrollit në shfrytëzimin e të dhënave personale për vijuesit e trajnimit nga bazën e të dhënave (data baza)		1	3	3	Njoftimi i personelit se askush nuk duhet të marrë të dhëna personale pa kërkesë dhe Monitorimi i kërkesave në bashkëpunim me DTI për qasje në bazën e të dhënave.	DTPA	- Çdo vit njoftohet stafi - Hartimi i raportit vjetor i monitorimit
		Parandalimi i qasjes në Armë dhe municion nga personat e paautorizuar		1	4	4	Inspektimi i Armëtores lidhur me respektimin e protokolleve të sigurisë. Inspektimi i kërkesave për armë dhe municion sipas procedurave standarde.	DTPA	Raportim vjetor